



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2021:061599  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05248861

**C.nr.192/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Betim Behluli, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësve H. G. nga fshati K., S. T. nga fshati K., N. T., nga fshati K., M. B. nga fshati B. Komuna e Malishevës dhe S. M. nga fshati G., Komuna e Klinës të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Haki Kryeziu nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, jashtë seancës gjyqësore, me datën 19.01.2024 muar këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve H. G. nga fshati K., N.T., nga fshati K., M. B. nga fshati B. Komuna e Malishevës.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t`ua paguaj paditësve në vijim:

- Paditësit **H.G.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën për vitin 2020 - 2022 për 345 ditë pune t`ia paguaj nga dy euro në shumën prej **690.00 euro**;
- Paditësit **N.T.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën për vitin 2020 - 2022 për 345 ditë pune t`ia paguaj nga dy euro në shumën prej **690.00 euro**;
- Paditësit **M.B.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën për vitin 2020 - 2022 për 345 ditë pune t`ia paguaj nga dy euro në shumën prej **690.00 euro**;

**III. APROVOHET** pjesërishtë si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S. T. nga fshati K., Komuna e Malishevës dhe S. M. nga fshati G., Komuna e Klinës.

**IV. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t`ua paguaj paditësve në vijim:

- Paditësit **S. T.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën për vitin 2021 për 230 ditë pune t`ia paguaj nga dy euro në shumën prej **460.00 euro**;

- Paditësit **S. M.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën për vitin 2020 - 2022 për 330 ditë pune t'ia paguaj nga dy euro në shumën prej **660.00 euro**; me kamatë prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë datë 31.03.2021, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbaramit të detyrueshëm.

**V. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkespadiës e kërkuar në emër të shujtave për paditësin S.T. për 115 ditë pune dhe paditësin S. M. për 15 ditë pune.

**VI. DETYROHET** e paditura që paditësve pjesërisht t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 320.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 30.00 euro, ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e shpenzimeve të paditësit në emër precizimit të padisë shumën prej 150.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 30.00 euro.

### A r s y e t i m

Paditësit H. G. nga fshati K., S. T. nga fshati K., N. T., nga fshati K., M. B. nga fshati B. Komuna e Malishevës dhe S. M. nga fshati G., Komuna e Klinës përmes të autorizuarit të tyre Av. Haki Kryeziu nga Malisheva, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësit janë mësimdhënës në SHMP “L.P.” në fshatin K., Komuna e Malishevës, punëdhënësi, përkatësisht e paditura edhe pse ka qenë e obliguar sipas kontratës që punëtorëve të arsimit t'ua paguaj ushqimin ditor për ditë të punës, deri me parashtrimin e padisë nuk e ka zbatuar kontratën, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkespadinë e paditësve si të bazuar.

I autorizuari i paditësve përmes parashtrësës së datës 15.11.2022 ka bërë precizimin e padisë duke i bashkangjitur edhe vërtetimet e punës, ashtu që në emër të kompenzimit të shujtave ditore t'ua paguaj si në vijim paditësit H.G. nga B., në emër të kompenzimit të shujtave për 345 ditë mësimi, për periudhën prej datës 01.02.2020 deri me datën 21.11.2022, duke llogaritur shumën e shujtës ditore prej 2.00 euro, gjithsejtë 690 euro, paditësit N.T. nga Kijeve, në emër të kompenzimit të shujtave për 345 ditë mësimi, për periudhën prej datës 01.02.2020 deri me datën 21.11.2022, duke llogaritur shumën e shujtës ditore prej 2.00 euro, gjithsejtë 690 euro, paditësit M. B. nga B., në emër të kompenzimit të shujtave për 345 ditë mësimi, për periudhën prej datës 01.02.2020 deri me datën 21.11.2022, duke llogaritur shumën e shujtës ditore prej 2.00 euro, gjithsejtë 690 euro, paditësit S. T. nga K., në emër të kompenzimit të shujtave për 405 ditë mësimi, për periudhën prej datës 01.02.2020 deri me datën 21.11.2022, duke llogaritur shumën e shujtës ditore prej 2.00 euro, gjithsejtë 810 euro, paditësit S.M. nga G., në emër të kompenzimit të shujtave për 345 ditë mësimi, për periudhën prej datës 01.02.2020 deri me datën 21.11.2022, duke llogaritur shumën e shujtës ditore prej 2.00 euro, gjithsejtë 690 euro, më kamat 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 320 euro, për përpilimin e precizimit të padisë shumë prej 150 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 60 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi të parashtruar me datë 30.06.2021, ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar padinë e paditësve të pa bazuar në fakte dhe në gjendjen faktike, sepse kërkesa e palës nuk është tani e mbështetur në kontratën kolektive të dt: 18.04.2017, për faktin së kjo kontratë kolektive ka qen e lidhur vetëm për tri vite ashtu siç e përcakton ligji i punës neni 90 i tij dhe kjo kontratë ka skaduar rënë dt: 18.04.2020 dhe kjo shumë e borxhit sipas dispozitave të LMD është e parashkruar, pasi kontrata kolektive nuk ka më bazë ligjore dhe është e skaduar, poashtu duhet theksuar së më këtë rast sipas dispozitave të LMD-së që ka të bëjë me kontratat komuna e Malishevës — DKAE nuk është nënshkruese e kësaj kontrate por është MASHT dhe këto raste kjo ministri nuk ka ofruar buxhet për këto kategori edhe përse është nënshkruese e kësaj kontrate, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar në kontratën kolektive pasi kërkesa padia e paditësve është përtej afatit sa ka qen kontrata kolektive në fuqi .

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin H. G. Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.361 të datës 03.03.2021, Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.1/14 të datës 12.12.2022, për paditësin N. T. Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.1/12 të datës 14.12.2022, Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.361 të datës 24.02.2021, për paditësin M. B. Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.1/42 të datës 12.12.2022, Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.346 të datës 24.02.2021, për paditësin S. M. Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.1/72 të datës 23.11.2022, Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.351 të datës 24.02.2020, S. T. Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.348 të datës 24.02.2021.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, ndërsa e aprovoj pjesërishtë për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Lartë “L. P.” në K., po ashtu nuk është kontestuese edhe drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se **“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet**

**arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim**”, kjo gjykatë vlerëson se paditëseve i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t’ua aprovojë sipas periudhës për vitin 2020 dhe 2022 gjatë të cilës paditësit kanë punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetuan edhe nga vërtetimet e lartcekura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditëseve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja padinë e ka parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2017 dhe të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkonë realizimin e të drejtave gjatë periudhës

në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit duke aprovuar pjesërishtë kërkespadinë e paditësve S. T. dhe S.M., duke u mbështetur në vërtetimet e punës, ndërsa pjesën tjetër mbi kërkesat e aprovuara gjykata vendosi të refuzoj si të pa bazuara si në pikën IV të dispozitivit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (31.03.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”* dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguajë shumën prej 320.00 euro në emër të parashtrimit të padisë dhe shumën prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore, ndërsa e refuzoi shumën prej 150.00 euro të kërkuar në emër të shpenzimeve për precizimin e kërkesëpadisë dhe shumën prej 30.00 euro në emër të shpenzimeve për taksë, sipas dispozitës së lartcekur mbi shpenzimet procedurale.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 , dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.192/21 me datën 19.01.2024**

**G j y q t a r i**  
**Betim Behluli**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.